



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

V.KA.nr.344-1/22

Prishtinë, datë 14.04.2022

KOMISIONI PËR ANKESA I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVOËS - në Kolegjin e përbërë nga Agon Rexhaj – Kryesues i Kolegjit, Daut Rudi dhe Edona Sina anëtar, me pjesëmarrjen e Vjollca Ajeti në cilësi të procesmbajtëses, duke vepruar sipas aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1101/2018 i datës 24.08.2021 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative AA.nr.956/2021, në seancën jo publike të mbajtur me datë 14.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **PUSHOHET** procedura disiplinore ndaj të paraqitures av. _____ nga _____
- II. **KOMISIONI PËR ANKESA** duke vendosur sipas detyrës zyrtare dhe aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1101/2018 i datës 24.08.2021 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit e Kosovës- Departamenti për Çështje Administrative AA.nr.956/2021, në lëndën ndaj të paraqitures av. _____ me seli të zyrës në Prishtinë, konstaton se është arritur afati i parashkrimit absolut, konform nenit 56 par.2 të Ligjit për Avokatinë, për shkak se nga dita e kryerjes së shkeljes disiplinore (05.01.2016) e deri më sot kanë kaluar më shumë se dy vite vite.

A r s y e t i m

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1101/2018 i datës 24.08.2021 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative AA.nr.956/2021 me të cilin është refuzuar ankesa e Odës së Avokave të Kosovës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, ku me të cilin aktgjykim është anuluar vendimi i Odës së Avokatëve të Kosovës–Komisionit për Ankesa me shenjën V.KA.nr.42-12/17 i datës 07.02.2018 dhe çështja i është kthyer OAK-së për rishqyrtim dhe rivendosje.

Komisioni për Ankesa i OAK-së në seancën jo publike të mbajtur me datë 14.04.2022, pas referimit të rastit, shikimit të shkresave të lëndës, dhe aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1101/2018 i datës 24.08.2021 dhe

aktgjykimit të Gjykatës së Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative AA.nr.956/2021, dhe pas shqyrtimit me kujdes të të gjithave shkresave të lëndës, erdhi në përfundim se lidhur me këtë çështje është arritur afati absolut i parashkrimit për ndjekje disiplinore, konform nenit 56 par.2 të Ligjit për Avokatinë i cili parasheh: *"Fillimi i procedurës disiplinore për shkelje të rënda parashkruhet një (1) vit pas njoftimit për shkeljen e bërë dhe kryesin, kurse në çdo rast parashkruhet pas kalimit të afatit kohor prej dy (2) vjetësh prej ditës së kryerjes së shkeljes"*.

Nga koha e shkeljes disiplinore të pretenduar, e të paraqitures av [redacted] ka kaluar më shumë se dy (2) vite, sepse shkelja e pretenduar është kryer me dt. 05.01.2016, dhe e njejta konsiderohet datë e kryerjes së shkeljes së pretenduar disiplinore.

Andaj, Komisioni për Ankesa i Odës së Avokatëve të Kosovës, konform nenit 56 par. 2 të Ligjit për Avokatinë, neneve 43 dhe 44 të Rregullores për Procedurë Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë të OAK-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI I ANKESAVE I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS

Prishtinë, V.KA.nr.344-1/22 data 14.04.2022

Kryesuesi i Kolegjit

Av. Agon Rexhaj

